

**POLITIKA E PRIVATËSISË
DHE
POLITIKA E VËZHGIMIT ME KAMERA
NË AMBIENTET E AGRO & SOCIAL FUND SH.P.K**

POLITIKAT E PRIVATËSISË

Të nderuar vizitorë të faqes zyrtare të Agro & Social Fund sh.p.k (ASF), nëpërmjet Politikës së Privatësisë ju përcjellim informacion mbi menyrën e trajtimit të të dhënave që mund të marim nëpërmjet faqes zyrtare të webit dhe trajtimi i tyre konform Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar.

Të gjithë ju që aksesoni Faqen Zyrtare – www.asf.al duhet të bini dakord me këtë Politikë. Ju lutem, mos vijoni të aksesoni dhe të navigoni në Faqen Zyrtare nëse nuk jeni dakort me to. Në të kundërt, do të quhet se e keni pranuar këtë Politikë.

Kur ndani informacione me ne, n'a ndihmoni t'ju shërbejmë më shpejt me produktet tona. Ndërsa lundroni në faqen tonë zyrtare website, ne duam që ju të jeni të qartë se si po përdorim informacionin dhe mënyrat në të cilat mund të keni privatësinë tuaj. Kjo është e rëndësishme dhe ne shpresojmë që ju do të merrni kohë për t'a lexuar me kujdes.

Me anë të Faqes Zyrtare, ASF përcjell tek ju informacion rreth aktivitetit që zhvillon, produktet e kredisë nëpërmjet të cilave ju shërbejmë të gjithëve ju dhe angazhimin për t'i asistuar grupeve të caktuara shoqërore që ballafaqohen me vështirësi ekonomike dhe të përjashtuar nga shërbimet financiare, të cilëve ju kufizohen mundësitë për të adresuar varfërinë, përmirësuar nivelin e jetesës, të ardhmen e fëmijëve dhe komuniteteve ku jetojnë.

ASF e konsideron mbrojtjen e privatësisë dhe të të dhënave personale çështje të një rëndësie të veçantë, ndaj është anagazhuar në zbatimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor në mbrojtje dhe respektim të tyre Të dhënat që ne marrim nga ju, në faqen tonë zyrtare të web-it, i trajtojmë bazuar në:

- **Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë,**
- **Ligjin Nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale",**
- **Ligjin Nr.9918, datë 19.05.2008 "Për Komunikimet Elektronike dhe Postare", si dhe aktet e tjera nënligjore në plotësim.**

Subjektet e të dhënave personale kanë të drejtë të kërkojnë akses në të dhënat e tyre si dhe të kërkojnë që këto të dhëna të korrigojnë apo të përditësohen në përputhje me kërkesat e nenit 13 dhe 18 të Ligjit 9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar. Kërkesa mund të drejtohet në adresën: info@asfund.org ose duke paraqitur kërkesë me shkrim pranë Selisë së Agro & Social Fund sh.pk: Rruga. "Nikolla Lena", Hyrja 1, Ap. 25, Tiranë, Shqipëri.

Agro & Social Fund rezervon të drejtën që të ndryshojë apo modifikojë këtë politike në çdo kohe, në zbatim të ndryshimeve të mundshme të legjislacionit në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale dhe privatësisë.

POLITIKA E VËZHGIMIT ME KAMERA

Politika e vëzhgimit me kamera në ASF është në përputhje të plotë me Ligjin nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar me Ligjin nr. 19/2016 “Për masat shtesë të sigurisë publike” si dhe me udhëzimin e miratuar nga Komisioneri nr. 46, datë 26.03.2017 “Për përcaktimin e nivelit të sigurisë për përpunimin e të dhënave personale nëpërmjet sistemeve të sigurisë, në zbatim të ligjit nr. 19/2016 “Për masat shtesë të sigurisë publike”. Aplikimi i sistemit të kamerave në zyrat tona dhe përpunimi i të dhënave personale nëpërmjet këtij sistemi të masave shtesë të sigurisë është në përputhje me qëllimin e parashikuar në ligjin nr. 19/2016 “Për masat shtesë të sigurisë publike” si dhe me interesat ligjorë të organizimit dhe funksionimit të Agro & Social Fund në cilësinë e subjektit privat. Të dhënat personale që përpunohen nëpërmjet sistemit të videosurvejimit me kamera CCTV në zyrat tona, trajtohen në përputhje me nenin 14 të Ligjit nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar. Sistemi i videosurvejimit nuk mund të ndërhyjë dhe të cënojë jetën private të klientëve, punonjësve tanë dhe të individëve të tjerë. Rregjistrimet mund të përdoren vetëm për hetimin e një ngjarjeje që ka sjellë dëmtimin e pronës, të bazës materiale dhe funksionale të ambienteve të ushtrimit të aktivitetit të ASF-së, si dhe të interesave të mbrojtura me ligj. Legjitimiteti i përdorimit të të dhënave të regjistruara për qëllime të tjera është i kufizuar vetëm për një interes të rëndësishëm publik sipas qëllimit të ligjit 19/2016 “Për masat shtesë të sigurisë publike”. Konform qëllimit të mësipërm në ambientet e ASF-së janë vendosur kamera në hyrje dhe në ambientin e brendshëm të zyrave tona.

Në hyrje të zyravë tona gjeni të afishuar tabelën përkatëse infomuese sipas modelit zyrtar të miratuar nga Zyra e komisionerit në mënyrë që të garantohet informimi i individëve për sistemin e monitorimit me kamera

Të gjitha kamerat janë të vendosura dhe të pozicionuara në një mënyrë të tillë që këndi i vrojtimit të jetë i tillë që të mund të filmojë pamje brenda qëllimit për të cilin është instaluar sistemi dhe nuk mund të filmojnë imazhe nga ambiente të cilat nuk përputhen me qëllimin e mbikqyrjes.

Kohëzgjatja e ruajtjes së të dhënave është në përputhje me ligjin 19/2016 “Për masat shtesë të sigurisë publike”, më pas, automatikisht, të dhënat fshihen.

Politika e survejimit me kamera është në përputhje me qëllimin e parashikuar në ligj dhe garanton ushtrimin e të drejtës së çdo personi për të konsultuar përpunimin e të dhënave përkatëse, për të verifikuar, ndryshuar apo fshirë informacionet e tyre. Për ta realizuar këtë të drejtë si dhe për t’u informuar në mënyrë të përgjithshme mbi politikat e video survejimit CCTV ndiqen të gjitha procedurat ligjore që diktohen Ligji “Për Mbrojtjen e të dhënave personale”.